



Udh. Prot. 2-180/6186
Nr. ifaq. 2
Data 02/10/2020



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/_23_;
Datë: 07.09.2020 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 07.09.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për
formimin e Komisionit për hartimin e (projekt) Planit pesëvjeçar për zhvillim ekonomik të komunes së Junikut

I. Me këtë vendim formohet Komisioni për hartimin e (projekt) Planit pesëvjeçar për zhvillim ekonomik të komunes së Junikut/në tekstin e mëtejme Komisioni/.

II. Komisioni ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin në harmoni me ligjet në fuqi si dhe nevojat dhe mundësitë e komunes së Junikut për zbatimin e tij.

III. Komisionin e përbejnë 6 anetare. Tre nga radhet e kuvendit kurse tre nga radhet e ekzekutivit.

III.1. Perberja nga radhet e kuvendit:

1. Albert Gjocaj;
2. Zeqë Hebibi; dhe
3. Florim Shala.

III.2. Perberja nga ana e ekzekutivit:

1. _____,
2. _____,
3. _____,
4. _____,

IV. Pas hartimit të (projekt) Planit nga ana e Komisionit, (projekt) Planin i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem KRASNIQI

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 297

<http://rks-gov.net/junik>